



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 394/3 Prot.

Vlorë, më 18.02.2020

VENDIM

Nr. 65, datë 18.02.2020

**PËR
VKM NR. 778, DATË 26.12.2018**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM-së Nr. 778, datë 26.12.2018 për një ndryshim dhe shtesë në VKM Nr. 288, datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", shkresës së MASR-së Nr.1036 Prot, datë 06.02.2020 protokolluar pranë nesh me Nr.317 Prot, datë 07.02.2020, Senati Akademik në mbledhjen e datës 18.02.2020

VENDOSI:

1. Për studentët e regjistruar në vitet pas të parit, notë mesatare mbi 6 (gjashtë) do të konsiderohet nota e cila përfshin shlyerjen e të gjitha detyrimeve akademike të parashikuara në programin e studimit për atë vit akademik.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Edukimit për Ciklin e Parë dhe të Dytë, kryesekretaritet dhe sekretaritet mësimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

